

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PDK-ja e gatshme të diskutojë për presidentin, nëse kalon projektligji për Specialen
ADRESA	https://lapsi.al/pdk-ja-e-gatshme-te-diskutoje-per-presidentin-nese-kalon-projektligji-per-specialen-i1094623
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 10:33:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 10:32:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1bf2104777a8385406fa6b1b3d02d6b974a78e845f02083eb3b7d0f07ae83b4e
TEKSTI	fd4f837f1f57bcb946d89f8619d2e89f239f156f7896c2b816bb79fd713c3dc6
PAMJA	a3afb28915a9fd3ac085fc4b50bf39228fe13da4099ede3f60dedafbb149842a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c8a0b245d7449c4b9d9a61d56fd06129a0db5fd2eecb03547fc693cf9a920f6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c8a0b245d7449c4b9d9a61d56fd06129a0db5fd2eecb03547fc693cf9a920f6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

PDK-ja e gatshme të diskutojë për presidentin, nëse kalon projektligji për Specialen

LAPS1.AL • 28 SEPTEMBER 2026



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë se nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, subjekti më i madh opozitar në Kosovë është i hapur të diskutojë për temat e tjera me partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje (LVV).

Në një deklaram për media para seancës së të hënës në Kuvendin e Kosovës, Hamza tha se për këtë projektligj ka diskutuar edhe me kryeministrin Albin Kurti, në një takim të mbajtur të dielën. Sipas Hamzës, në takimin me kreun e LVV-së, Kurti, është biseduar edhe çështja e zgjedhjes së presidentit, por pa diskutuar rreth emrave të mundshëm.

"Nuk kemi shkuar për emrat, nuk i kemi folur, nëse kalohet ligji jemi të hapur edhe për tema tjera", tha ai.

Hamza shtoi se duhet pritur ditët në vijim për të kuptuar nëse LVV mbështet këtë projektligj, i cili, sipas tij, është domosdoshmëri për PDK-në dhe prioritet për historinë dhe të ardhmen e Kosovës.

"Ne nuk po kërkojmë që të ndalet drejtësia, ne jemi kundër padrejtësisë", tha Hamza, ndërsa shtoi se as partitë e tjera nuk kanë arsye për të mos e mbështetur.

PDK-ja dorëzoi projektligjin në Kuvend më 21 shtator, disa ditë pasi ajo që njihet si Gjykata Speciale e Kosovës dënoi me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte katër ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK): Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin.

Në dokumentin e ndryshimeve të propozuara, të cilën e ka parë Radio Evropa e Lirë, kërkohet ndër të tjera, që dënimet më të larta që mund të shqiptohen nga Gjykata në Hagë të jenë 15 vjet burgim dhe që të dënuarit të mund të jenë subjekt i faljes presidenciale.

Mbështetje kësaj nisme i ka dhënë Aleanca, teksa nga LVV-ja thanë se do të shqyrtojnë fillimisht në aspektin juridik ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk ka

ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsia



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

24°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:00

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vllora Hysenit me drejtësisë

22:06



Rama nisët sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



një qëndrim zyrtar për këtë. Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu tha se projektligjin e PDK-së e ka dërguar te një ekip ekspertësh, por ende nuk mund të japë një vlerësim për përmbajtjen e tij.

Megjithatë, ajo pati kritika që për të nuk ka pasur konsultime, duke shtuar se do të ishte më e drejtë që ai të hartohej nga Komisioni për legjislacion ose paraprakisht të konsultohen ekipet mbrojtëse të katërshe të UÇK-së dhe ekspertë të fushës.

Çështja e presidentit

Në një aktgjykim të 23 shtatorit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës sqaroi se afati për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit është deri më 6 tetor. Sipas saj, afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht, nga dita kur u konstituua Kuvendi, dhe përfundon më 6 tetor.

Që nga 4 prilli, Kosova është me ushtrues detyre të presidentit. Ky funksion, sipas Kushtetutës, nuk mund të ushtrohet më shumë se gjashtë muaj. Pas rundesh të bisedimeve mes LVV-së dhe LDK-së së Lumir Abdixhikut, palët arritën një marrëveshje në fund të gushtit për një president konsensual, dhe dy partitë propozuan për postin e presidentit Bekim Sejdiu.

Por, një ditë pas njoftimit për marrëveshjen u bë e ditur se gjashtë deputetë të LDK-së nuk e përkrahnin këtë kandidaturë – duke bërë që, në praktikë, Sejdiu të mos kishte 81 votat e nevojshme – dy të tretat e Kuvendit me 120 ulëse, që kërkohen për procesin e zgjedhjes së presidentit.


Megjithatë, më 14 shtator Sejdiu njoftoi se tërhiqet nga kandidatura për president për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për zgjedhjen e tij. Kosova rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja – që do të ishin të katërtat që nga shkurti i vitit 2025 nëse partitë nuk gjejnë ujdi që ta zgjedhin kreun e ri të shtetit para afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese./REL

Të këshilluara




Digjet grumbulli i mbetjeve në Lezhë, flakët rrezikuan disa banesa

Një zjarr ka rënë ditën e sotme në një grumbull mbetjesh në lagjen e Spitalit në Lezhë. Pas kësaj zjarri &eum...



“Armand Duka jam”/ Tentuan t’i zhvasnin 100 mijë euro një 64-vjeçari

Dy të rinj janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi përmes mashtrimit në rrjetet sociale, tentuan të zhvasn...



Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori




Pse nuk bind alibia e kryeministrit "Ileshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë \$ në Shqipëri



Një histori korruptimi jo dashurimi



Ambasadorja e BE-së: Shqipëria të çojë deri në fund reformat e nisura



Këshilli Bashkiak i Maliqit kundër bashkimit me Korçën, 21 anëtarë votojnë kundër, vetëm 1 pro

Këshilli Bashkiak i Maliqit ka kundërshtuar propozimin për bashkimin e kësaj bashkie me Bashkinë e Korçës, në kuadër të...



Udhëheqësja e opozitës suedeze: Nuk mund të formoj qeveri në situatën aktuale

Kryetarja e Social Demokratëve suedeze, Magdalena Andersson tha të hënën se nuk ishte në gjendje të formonte një qeveri...



Shpërdanin drogë pranë shkollave, vepronin 8 grupe në Tiranë

Detaje të reja dalin nga operacioni antidrogë i zhvilluar në Tiranë, për goditjen e rrjetit që shpërndante lëndë n...



Avokatët zgjerojnë bojkotin në GJKKO, nisin sot protestën edhe ndaj seancave për masat e sigurisë



Skandal financiar në Turqi, zyrtarja e lartë e AKP-së jep dorëheqjen

Një hetim i gjerë financiar ka shkaktuar përplasje politike në Turqi, ndërsa një zyrtare e lartë e partisë në push...



Shoqatat e Gjyqtarëve refuzojnë ftesën e Ramës për konsultim për pagat: Presim vendimin e 'Kushtetueses'

Shoqata e Gjyqtarëve të Shqipërisë ka refuzuar ftesën e kryeministrit Rama për të marrë pjesë në tryezën...



Këshilli i Sigurisë në mbledhje, PD: "Shkaktarët s'mund të jenë shpëtimtarë", kërkohet qeveri teknike

Partia Demokratike thotë se mbledhja e sotme e Këshillit të Sigurisë lidhur me zhvillimet e fundit në vend pas arrestit të ish-kr...

Me sytë katër



19:19

VIDEO/ Qëllohet me vezë kryeministri hungarez Péter Magyar

Një incident ka ndërprerë fjalimin e kryeministrit hungarez Péter Magyar gjatë një aktiviteti elektorale në qytetin e Szoln...



VIDEO/ Theu derën e supermarketit në Vlorë dhe mori kasën, por u arrestua

17:23



“Më shau, e shava”/ Shefi i komisarariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

21:35



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44


SPORT

→ Të tjerë artikuj



12:27

Manchester City thyen heshtjen pas vendimit: "Ka shumë gjëra që nuk mund t'i themi"



11:05

Asnjë udhëtim në Turqi për 10 lojtarë të Italisë: Mancini lë në shtëpi Barella dhe Mancini



22:12

Lojtarët e Irlandës refuzojnë të shtrëngojnë duart me skuadrën e Izraelit



12:00

Maran nuk pajtohet me Gjimshitin: "Nuk jam surprizuar nga Bjellorusia"



23:17

Shqipëria mposht Bjellorusinë, Gjimshiti, Ismajli dhe Muçi flasin pas ndeshjes



22:47

Asllani e Muçi i japin fitoren e parë Maran në Nations League: Bjellorusia dorëzohet në Tiranë



15:01

“Hesht, i hëngre dy”, Lukaku e provokoi, tërbohet Donnarumma: inati i së kaluarës në Itali-Belgjikë



Nga pallati mbretëror drejt Afrikës së Jugut: Plani sekret i Princeshë Dianës me Hasnat Khan

15:28



"Free Palestine", Macklemore nis turneun e ri pas përplasjes me Ed Sheeran

15:18



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.